



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 712/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të BOE “Ouen” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Nyja F.Dukagjin-L. Rr.Kombit, U.Drinit (Hyrja Kukës)-Sh.Galica, Sh.Galica-Krumë, Krumë-Q.Prushi, Plepa-Kam 77.6 km*”, me nr. REF-73879-06-07-2018, me fond limit 79,385,966 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

**Ankimues:** BOE “Ouen” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k.  
*Adresa: Rruga Nacionale Shemri-Kukës, Km 2, Kukës.*

**Autoriteti kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër  
*Adresa: Lagjia “3 Heronjt”, Rr.”At Zef Valentini”, Shkodër.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

*nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave  
"Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të  
Prokurimit Publik";*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*";

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 08.06.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, "*Procedurë e Hapur*", me objekt, "*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Nyja F.Dukagjin-L. Rr.Kombit, U.Drinit (Hyrja Kukës)-Sh.Galica, Sh.Galica-Krumë, Krumë-Q.Prushi, Plepa-Kam 77.6 km"*, me nr. REF-73879-06-07-2018, me fond limit 79,385,966 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

II.2 Në datën 09.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3.Në datën 03.08.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Haziri" shpk & "Ndregjoni" shpk,	64,697,287 lekë Skualifikuar;
2. "Ouen" shpk & "Shpresa Al" shpk,	68,800,601 lekë Skualifikuar;
3. "Alb Shpresa" shpk & "Curri" shpk,	69,500,000 lekë Skualifikuar;
4. "Griald" shpk & "Kombeas" shpk,	75,308,656 lekë Kualifikuar;
5. "Marsi" shpk & "Armemil" shpk,	77,849,810 lekë Kualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se BOE "Ouen" sh.p.k & "Shpresa Al" sh.p.k është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

*"Nuk plotsoni kushtet e kualifikimit pasi ne QKB nuk keni të shenuar Mirmbajtje Rutine e dimrore rrugesh as "OUEN dhe as "Shpresa-Al " sipas kerkesave te DST"*

II.5.Në datën 08.08.2018 BOE ankimues "Ouen" sh.p.k & "Shpresa Al" sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 340 Prot. datë 15.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues "Ouen" sh.p.k & "Shpresa Al" sh.p.k, duke mos pranuar pretendimet e ngritura prej tij.

II.7.Në datën 23.08.2018 BOE ankimues "Ouen" sh.p.k & "Shpresa Al" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*"[...]Pretendimet tona rreth vendimit të gabuar të KVO: Sqarojme se Bashkimi i shoqerive "OUEN" shpk dhe "Shpresa-AL" shpk, e kanë të pasqyruar në ekstraktim e tyre pretendimin që ka shprehur KVO si kushte për s'kualifikimin e tyre nga kjo procedure. Theksojme se Shoqeria "OUEN" shpk e ka të theksuar në Ekstraktin e saj objektin "PUNIME TE ZBATIMIT NE NDERTIM" objekt i pergjithshem qe perfshin edhe objektin e pretenduar nga KVO. Shoqeria "SHPRESA AL" shpk e ka objektin e veprimtarise "AKTIVITET NDERTIMI, SHERBIME PUBLIKE" object i aktivitetit qe perfshin edhe arsyen e s'kualifikimit nga KVO. Gjithashtu sqarojme se Bashkimi i Shoqerive te mesiperme e kanë pasur si procedure dhe e kanë realizuar me sukses kete sherbim "MIREMBAJTJE RUTINE E DIMERORE Fushe Arrez Nyja Fushe Dukagjin" ne vitin e meparshem. (bashkengjitur Formulari i Realizimit me suksese te kesaj kontrate" Sqarojme se Licensat e shoqerive te mesiperme jane sipas kerkesave te DST e shoqerite e mesiperme i kanë*

plotesuar te gjitha pikat e kerkuara ne Kriteret e Kualifikimit. Per plotesimin e kriterit te pikes 3.1 Kapaciteti ligjor dhe profesional i operatoreve ekonomik, ne si operator ekonomik kemi dorzuar dokumentacionin si me poshte : Ekstraktin Historik dhe Tregetar te shoqerise OUEN shpk dhe Shpresa Al shpk, ne te dy ekstraktet e shoqerise eshte i pasqyruar objekti i aktivitetit dhe veprimtarise se shoqerive i cili perfshin objektin e prokurimit, per subjektin Ouen shpk objekti i veprimtarise eshte “PUNIME TE ZBATIMIT NE NDERTIM”, ndersa per subjektin “Shpresa Al ” shpk objekti i veprimtarise eshte “ ..... aktivitet ndertimi, sherbime publike”. Licencen e shoqerise Ouen shpk dhe Shpresa-Al shpk ne te cilen jane te pasqyruara te gjitha kategorite e licences te kerkuara sipas kriterit te percaktuar ne 2.3.6 te DT. Formularet e Vleresimit bashke me kontratat e sherbimit te kerkuara nga AK ne piken 2.3.1 te Kpacitetit Teknik te DT. Vlereson te theksojme faktin se per plotesimin e kriterit per kontratat e ngjashme te dyja shoqerite tona kane realizuar kontrata te ngjashme me object: “Mirembajtje rutine e dimerore rruges” pikerisht me Drejtorine e Rajonit Verior Shkoder, kontrata te cilat jane realizuar me sukses dy vitet e fundit dhe ne lidhje me kete fakt eshte leshuar dhe formulari i vleresimit nga Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder me vleresim “Shume mire”. Deklaraten per permbushjen e kriterëve te pergjithshme per subjektin Ouen shpk dhe Shpresa - Al shpk sipas shtojces 7 te DT. Ne gjykojme se objekti i veprimtarisë së një shoqërie tregëtare i pasqyruar në ekstraktin e qendrës kombëtare të regjistrimit ndryshe nga sa pretendon KVO ka karakter pergjithësues dhe nuk mund të jetë i detajuar me të gjithë elementët që parashikojnë specifikimet teknike për realizimin e një objekti konkret prokurimi. Sa me siper kriteri i vendosur ne piken 3.1 eshte permbushur plotesisht nga ana jone, pasi me te gjithë dokumentat e cituara me siper eshte e provuar katerciperisht se te dyja subjektet tona kane aftesine dhe kapacitetet per te realizuar kete objekt prokurimi. Arsyeya e perdorur nga KVO per skualifikimin e ofertes tone me argumentin “Nuk ploteson kushtet e kualifikimit pasi ne QKB nuk keni te shenuar Mirembajtje Rutine e dimrore rruges”, eshte nje arsye e cila nuk eshte kerkuar ne dokumentat e tenderit dhe si e tille perdorja e kriterëve per skualifikim te cilat nuk jane perfshire ne dokumentat e tenderit vjen ne kundërshtim me nenin 55/2 te ligjit nr.9643, date 20.1 1.2006 “Per prokurimin publik” te ndryshuar citaobj; 55/2 i LPP: 2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet etenderit. Te njetin qendrim KPP mban dhe ne vendimin KPP 50/2017 07.02.2017, pra qe ne objektin e veprimtarise se nje operatori ekonomik te pasqyruar ne QKR nuk mund te detajohet cdo gje qe perfshijne specifikimet teknike te nje objekti prokurimi apo akoma dhe me keq te perfshihet germe per germe titulli i kontrates qe prokurohet, pra objekti i veprimtarise ka karakter pergjithsues. Nisur dhe nga ky qendrim i mbajtur nga KPP ne ne dy vendime te ngjashme te permendura me siper kerkojme te mbahet i njejti qendrim dhe ankesa jone te pranohet pasi eshte plotesisht ne permbushje me te gjitha kriterëve te kerkuara. [...]

II.8.Në datën 06.09.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.365prot., datë 03.09.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të BOE ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Ouen” sh.p.k & “Shpresa AI” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : *“Nuk plotsoni kushtet e kualifikimit pasi ne QKB nuk keni të shenuar Mirmbajtje Rutine e dimrore rrugesh as "OUEN dhe as "Shpresa-AI " sipas kerkesave te DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1.Në pikën 3.1 të shtojcës 8, “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“-Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik”*

III.1.2. Në shtojcën 8 *“Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit”* të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

*a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

*b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

*b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*

*c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

*d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Marrëveshje Bashkim Operatorësh, ndërmjet shoqërisë “OUEN” sh.p.k. dhe shoqërisë ”Shpresa-Al” sh.p.k., nga ku shoqëria “OUEN” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 80% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria ” Shpresa-Al” sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 20% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “OUEN” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “OUEN” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 4 Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ku deklarohet se “Operatori ”OUEN” sh.p.k. është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.”.
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” lëshuar më 04.06.2018, nga ku rezulton se objekti i aktivitetit të shoqërisë “OUEN” sh.p.k. është si vijon: *“Punime të zbatimit në ndërtim. Tregtimin me shumicë e pakice, import-eksport të mallrave ushqimore, industriale, konfeksione, kinkalери, hidrosanitare, druri, elektroshtëpiake, pajisje elektronike, vegla auto, veshmbathje, ilaçe, lende ndërtimi, prodhime bujqësore e blektorale, lende të pare për industrinë, pjesë këmbimi, makineri e pajisje, kancelari, pajisje zyresh, pajisje shtëpiake dhe transport. Kryerjen e veprimtarive komisionere për llogaritë të tregut. Transport kombëtar dhe nderkombëtar të mallrave për nevojat e vetë shoqërisë "OUEN"sh.p.k. dhe për të treta. Përpunim dhe shfrytëzim i lëndës së drurit. Mbjellje e fidaneve pyjore. Import - Eksport, shitje me shumicë dhe pakice të lëndës së drurit. Shitje dhe blerje automjetesh.”*

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri*

*prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konkretisht në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “Kapaciteti ligjor/profesional”, autoriteti kontraktor, ka kërkuar shprehimisht që objekti i prokurimit të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së saj. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “OUEN” sh.p.k. rezultoi se ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit tregtar, në të cilin nuk konstatohet të ketë si veprimtari mirëmbajtje dimërore të rrugëve, ashtu siç është kërkuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa - AI” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga operatori ekonomik “OUEN” sh.p.k. nuk plotësohet kërkesa për objektin e veprimtarisë së shoqërisë në fushën e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve, sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se

komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi goftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa - AI” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Ouen” sh.p.k & “Shpresa AI” sh.p.k nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Ouen” sh.p.k & “Shpresa AI” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Nyja F.Dukagjin-L. Rr.Kombit, U.Drinit (Hyrja Kukës)-Sh.Galica, Sh.Galica-Krumë, Krumë-Q.Prushi, Plepa-Kam 77.6 km*”, me nr. REF-73879-06-07-2018, me fond limit 79,385,966 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1424 protokoli Datë 23.08.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**